



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 29 gusht 2012, në orën 10:00 salla N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci, Valbona Dibra dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm dhe Afrim Maloku-Deloitte.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – Koorditore; Mehmet Simnica - Zyrtar i fushës për ekonomi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 02 korrik 2012, prapë më 02 korrik 2012, 03 korrik 2012, prapë më 03 korrik 2012 dhe më 04 korrik 2012;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Performancës, dhe pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011;**
- 4. Të Ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtur më 02 korrik 2012, prapë më 02 korrik 2012, 03 korrik 2012, prapë më 3 korrik 2012 dhe më 04 korrik 2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, pa vërejtje njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02 korrik 2012, prapë më 02 korrik 2012, 03 korrik 2012, prapë më 03 korrik 2012 dhe 04 korrik 2012.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të përformancës dhe pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011

Kryetari – Raporti është hartuar nga kompania “Deloitte” e autorizuar nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike. Auditori nuk ka dhënë opinion. Hapi diskutimin.

Afrim Maloku, Deloitte – Deloitte ka audituar ZAP-in dhe nuk ka dhënë opinion lidhur me pasqyrat vjetore financiare, për arsye se të gjeturat nuk kanë qenë të asaj natyre që do të kishin ndonjë ndikim material.

Armend Zemaj – Për dallim nga e kaluara, në këtë raport janë të detajuara të gjitha të gjeturat. ZAP duhet të merret seriozisht me eliminimin e dobësive. Mos kompletimi i dosjeve të tenderit, mos kompletimi i dosjes së personelit, mungesa e afateve kohore nuk duhet të përsëriten nga ZAP-i në të ardhmen. ZAP është duke performuar në mënyrë të kënaqshme.

Ramiz Lladrovci – Është për t’u vlerësuar fakti që kompania “Deloitte” ka dhënë një opinion të pakualifikuar, përkundër disa të gjeturave si: mos kompletimi i dosjeve të personelit, si dhe në rekrutimin e stafit të ZAP-së. Pyeti: deri ku ka mbërritur ZAP-i në rekrutimin e stafit?

Mursel Haljilji- Kërkoj nga kompania “Deloitte” që të sqarojë se këto të gjeturat të cekura në raport a kanë të bëjnë me shkelje të proceduarve ligjore apo janë gabime teknike të cilat janë pasqyruar në pasqyrat financiare?

Afrim Maloku, Deloitte -Të gjeturat janë në disa raste shkelje të proceduarve, p.sh. kur bëhet fjalë për lidhje të kontratës pa zotim të mjeteve, ose mos barazim të pasqyrave në mes MF-së dhe ZAP-it, bankës komerciale NLB. Mirëpo, në disa raste janë edhe gabime teknike të cilat nuk kanë ndikuar në dhënien e opinionit për ZAP-in.

Valbona Dibra- Pyeti: në faqen 45 të raportit “*thuhet se kalimi i provimeve të kandidatëve nga Shoqata e Kontabilistëve është jo i kënaqshëm*”, a mos është kjo si rezultat i monopolit që ka kjo shoqatë, apo ku qëndron problemi?

Lars Lage OLOFSSON - Ky raport i auditimit e ka një opinion të auditimit si i pakualifikuar, për arsye se kur i lexoni pasqyrat financiare, informacioni i dhënë në to në disa aspekte janë vetëm lëshime teknike të cilat nuk kanë ndikim material e as financiar.

Sa i përket barazimeve në mes pasqyrave dhe shënimeve, këtu kemi të bëjmë me vitin 2010, por jo me vitin 2011. Rrumbullakimi i shifrave është për shkak se Ministria e Financave ka kërkuar që të raportohet në shifra të rrumbullakuara (në mija euro).

Mos barazimi i pasqyrave në mes ZAP-it dhe Ministrisë së Financave, Departamentit të Thesarit dhe bankave komerciale në këtë rast NLB-ja.

Afrim Maloku, Deloitte - Në këtë rast kemi të bëjmë me mos barazimin në mes pasqyrave në fund të vitit 2011 në mes ZAP dhe MF-së, për shkak se një shumë e mjeteve ka qenë në NLB e cila në fakt nuk është deklaruar nga MF-ja. Mirëpo, përgjegjësia është e ZAP-it, sepse ajo është dashur që të kërkojë informacion shtesë nga Banka Komerciale, ku edhe ka llogarinë e hapur dhe të ketë barazim me MF-në. Është një lëshim teknik, mirëpo kjo nuk bën të ndodhë në të

ardhmen.

Armend Zemaj- Tha se nuk do te thotë që për secilën çështje të diskutohet me Departamentin e Thesarit, po nëse flasim për OB-të të cilat përmes “Free Balances” qarkullojnë miliona euro, atëherë kjo duhet diskutuar.

Lars Lage OLOFSSON –Ekziston një bashkëpunim i mirë me MF-së dhe Departamentin e Thesarit. Kompanitë e mëdha që janë shpenzues të mjeteve buxhetore në mbi 100 OB dhe mbi 150 autoritete kontraktuese dhe për mbikëqyrjen e tyre është MF- si mbikëqyrës dhe në këtë rast është shumë vështirë të përcillet individualisht nga njësitë shpenzuese.

Po ashtu te pozicioni në vlerësimin e nevojave dhe disponueshmëria e fondeve, në disa raste ka pasur lëshime për shkak të harresës nga ana e zyrtarëve përgjegjës. Është çështje e vogël dhe se kjo ka ndodhur në dy raste, mirëpo nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Limitet në afatet kohore janë lëshime po ashtu teknike dhe për shkak të vëllimit të madhe të punëve këto gjëra kanë ndodhur në dy raste.

Pranimi i dosjeve të tenderit, me kohë e kemi dërguar materialin KRPP në një rast, ndërsa në një rast tjetër jemi vonuar në dorëzimin e materialit. Vërejtja është me vend, ZAP do të mundohet në të ardhmen të mos ketë vonesa të kësaj natyre.

Në një rast tjetër kemi lidhur kontratën për furnizim me ujë pa zotim të mjeteve, është shkelje e ligjit, mirëpo është vetëm në një rast dhe shuma e mjeteve është shumë e vogël.

Vërejtja në dosje të personelit sa i parket kontratave të punës, tani me ligj të ri mbi shërbimin civil kemi bërë kontrata të reja pune, gjegjësisht akt –emërimi dhe janë eliminuar këto lëshime, po ashtu edhe në një rast kemi te një punëtorë, i cili nuk e ka pasur dosjen e pushimeve vjetore në dosje të personelit ky punëtorë nuk është i rregullt, ka qenë punëtorë me kontratë, mirëpo është në bazën e të dhënave përbrenda ZAP-it.

Baza e të dhënave për personelin është në exel nuk është i mirë, mirëpo kemi planifikuar të kemi një softwer për menaxhimin e burimeve njerëzore, mirëpo Ministria e Administratës Publike thotë se për këtë do të lëshohet sistemi elektronik apo E-qeverisja, mirëpo deri tani nuk është bërë një gjë e tillë, edhe pse është testuar në Ministrinë e Drejtësisë.

Çështja e fundit është zhvleftësimi i pasurisë nën 1 mijë euro, ne kemi vendosur ato në vlerën e tyre historike, por nuk është kalkuluar norma e zhvleftësimit, për arsye se nuk është paraparë në këtë modul, në sistemin E-pasuria duhet të zhvleftësohen, mirëpo për vitin 2011 ne nuk kemi përdorë këtë sistem, por atë të MF-së.

Po ashtu niveli i kalueshmërisë së auditorëve është i vogël, mirëpo unë mendoje se me kalimin e kohës kjo çështje është tejkaluar ngase kemi një progres në këtë drejtim. Jemi duke u munduar të përshtatim skemën e re të certifikimit sipas standardeve të kërkuara, mirëpo nëse bazohemi shifrave ne raportin e performances ne kemi ecur mirë në këtë drejtim.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t`i paraqes këtë

REKOMANDIM

1. Të miratohet Raporti vjetor i performancës të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, me pasqyrat e audituara financiare, për vitin 2011.
2. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

4. Të ndryshme

Diskutim rreth mbledhjeve të planifikuara të Komisionit për datën 05 shtator 2012 dhe 12 shtator 2012

a) Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me kërkesën e drejtorit të Doganave, që në mbledhje të Komisionit të planifikuar për datën 05 shtator 2012, të

marrë pjesë zëvendësi i tij, për shkak të pamundësisë së tij për të marrë pjesë në mbledhje, me pesë vota “Për” dhe dy “Kundër” nxori këtë

Përfundim

1. Në mbledhjen e Komisionit të planifikuar për datën 05 shtator 2012, për shkak të pamundësisë së Drejtorit të Doganës për të prezantuar në mbledhje, pranohet zëvendës drejtori, meqenëse në mbledhje merr pjesë edhe ministri i Financave.

b). Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me kërkesën e Ministrit të MASHT-it që mbledhja e planifikuar për datën 12 shtator 2012, në orën 10:00, të shtyhet për në orën 13:00, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 1. Plotësohet rendi i ditës për mbledhjen e Komisionit të planifikuar për datën 12 shtator 2012.*
- 2. Në rend dite përfshihet edhe Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës.*
- 3. Mbledhja e planifikuar për datën 12 shtator 2012, në orën 10:00, shtyhet për 12 shtator 2012 në orën 13:00.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu